

VENDIM
Nr. 197, datë 26.3.2026

**PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME “ANSAMBËL
ARKITEKTONIK URBAN” TË FSHATIT LIN, PËRCAKTIMIN E ZONËS
MBROJTËSE TË TIJ DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN
DHE ADMINISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 3, shkronjat “a” e “ç”, dhe 62, pika 3, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme “Ansambël arkitektonik urban” të një zone në fshatin Lin, sipas hartës dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të “Ansamblit arkitektonik urban” të një zone në fshatin Lin, sipas hartës dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për publikimin e hartave të “Ansamblit Arkitektonik Urban” të fshatit Lin dhe zonës mbrojtëse në Gjeoportalin Kombëtar.

5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe me aktet nënligjore në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mjedisit dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN
E “ANSAMBLIT ARKITEKTONIK URBAN”, DHE TË ZONËS MBROJTËSE TË
TIJ NË FSHATIN LIN**

Neni 1
Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e “Ansamblit arkitektonik urban” dhe të zonës mbrojtëse të tij në fshatin Lin, si dhe kufijtë e tyre.

Fshati Lin dhe territori përreth tij gëzon status mbrojtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ai është pjesë e “Peizazhit të mbrojtur ujor/tokësor” (kategoria V) e liqenit të Pogradecit, referuar vendimit nr. 597, datë 25.9.2024, të Këshillit të Ministrave.

Për vlerat e pakrahasueshme universale, fshati Lin dhe territori përreth tij bën pjesë në

trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit, shpallur për vlerat e tij natyrore në vitin 1979 dhe për vlerat e tij kulturore (vetëm pjesa Maqedonisë së Veriut) dhe më 5 korrik 2019, në bazë të kriterëve “i”, “iii”, “iv” dhe “vii”.

Gjithashtu, në sesionin e 43-të të Komitetit Botëror të Trashëgimisë së UNESCO-s u miratua dhe pjesa shqiptare, si pasuri të trashëgimisë botërore, si edhe në rezerva ndërkufitare biosferë “Liqeni Ohër – Prespë”, e shpallur në sesionin e 26-të të Këshillit Ndërkombëtar të Koordinimit “Njeriu dhe biosfera”, në qershor 2014.

Neni 2 **Objekti**

Objekt i këtij plani janë:

1. Administrimi i “Ansambilit arkitektonik urban” dhe i zonës mbrojtëse të fshatit Lin, sipas hartës së zonifikimit që i bashkëlidhet këtij plani, si pjesë përbërëse e tij;
2. Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave arkitektoniko-kulturore dhe i vlerave të peizazhit të “Ansambilit arkitektonik urban” dhe territorit përreth tij;
3. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore e të peizazhit të “Ansambilit arkitektonik urban” të fshatit Lin dhe të zonës mbrojtëse të tij.

Neni 3 **Hapësira urbane në mbrojtje**

1. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Lin përbëhet nga:
 - a) ansambli arkitektonik urban;
 - b) zona mbrojtëse.
2. Brenda këtyre zonave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen pasuri kulturore objekte shoqërore, banesa tradicionale të lidhura ngushtë me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, zona të gjelbra, sheshe dhe rrjeti rrugor me prezencë kalldrëmi, si dhe parcela natyrore.
3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Pogradec merr parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së “Ansambilit arkitektonik urban” dhe të zonës mbrojtëse të tij.
4. Njësia e vetëqeverisjes vendore bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ministrinë përgjegjëse për mjedisin, institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore dhe institucionet përgjegjëse për zonat e mbrojtura për të siguruar, ruajtjen, miradministrimin dhe mbrojtjen e “Ansambilit arkitektonik urban” dhe zonës mbrojtëse përreth tij.

Neni 4 **“Ansambli arkitektonik urban” dhe kufijtë e tij**

1. “Ansambli arkitektonik urban” i fshatit Lin është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistiko-arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit arkitektonik të fshatit dhe arritjet në arkitekturë e në urbanistikë.
2. Kufijtë e “Ansambilit arkitektonik urban” paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Lin, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani. Koordinatat në sistemin referues zyrtar-KRGJSH paraqiten në aneksin 1, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5 **Zona mbrojtëse e “Ansambilit arkitektonik urban” dhe kufijtë e saj**

Zona mbrojtëse e “Ansambilit arkitektonik urban” të fshatit Lin shtrihet në pjesën jugore të tij dhe përbëhet nga:

1. Nënzona I mbrojtëse, e cila ruan vlera arkitektoniko-kulturore, me të cilat plotëson dhe pasuron vlerat e “Ansambilit arkitektonik urban” dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt tokave natyrore të fshatit Lin.

Kufijtë e nënzonës I mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Lin, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e këtij plani. Koordinatat në sistemin referues zyrtar-KRGJSH paraqiten në aneksin 2, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

2. Nënzona II mbrojtëse (zonë natyrore), e cila është zona që, përfshin të gjithë gadishullin e Linit, përbëhet nga toka natyrore, gjelbërim e bimësi të ndryshme dhe u shërben pamjeve panoramike të peizazhit kulturor.

Kufijtë e nënzonës II mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Lin, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e këtij plani. Koordinatat në sistemin referues zyrtar-KRGJSH paraqiten në aneksin 3, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6

Ndërhyrjet e lejuara në “Ansamblin arkitektonik urban”

1. Ndërhyrjet në “Ansamblin arkitektonik urban” kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, arkitektonike, urbanistike të fshatit Lin.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të “Ansambilit arkitektonik urban”, brenda kësaj zone, lejohen këto ndërhyrje:

a) Ndërhyrje sistematike mirëmbajtëse, konservuese, restauruese dhe rijetëzuese, sipas parimeve të konservimit të integruar;

b) Ndërhyrjet restauruese, që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale;

c) Rikonstruksioni/rindërtimi, të cilët duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansambilit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve dhe kriteret e përcaktuara në këtë plan;

ç) Rikonstruksioni/rindërtimi, në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, që mund të kryhen mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.;

d) Ndërtimet e reja, të cilat u nënshtrohen kriterëve të përcaktuara në këtë plan. Leja e ndërtimit jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e zhvillimin e territorit dhe legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Në rastet e ndërhyrjeve transformuese dhe me impakt në “Ansamblin arkitektonik urban”, nevojitet që projektet të shoqërohen me raportin e ndikimit në trashëgimi (RNT), hartuar në bazë të udhëzuesit të UNESCO-s për vlerësimin e ndikimit në kontekstin e trashëgimisë botërore.

Neni 7

Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të “Ansambilit arkitektonik urban”

1. Ndërhyrjet e lejuara në nënzonën I mbrojtëse janë:

a) ndërhyrje sistematike të mirëmbajtjes, konservuese, restauruese;

b) rikonstrukcione, rindërtime dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimi i kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të zonës dhe në respekt me kriteret e këtij plani;

c) rijetëzime, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar;

ç) vendosje e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosje e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar;

d) rikonstrukcioni i rrjetit rrugor dhe i shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës, apo realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale;

dh) ndërhyrje të mobilimit urban, me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementeve të tjera të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementeve, në harmoni me tipologjinë dhe vlerat tradicionale;

e) ndërhyrje për modifikimin e gjurmës rrugore, e lidhur me nevojat për funksionim dhe përdorimin sa më të mirë të zonës, brenda së cilës ndodhet rruga. Në rastet kur gjurma e rrugës, në të cilën ndërhyhet, shtrihet në disa zona, ndërhyrja u nënshtrohet kriterëve të zonës me mbrojtje më të lartë.

2. Ndërhyrjet e lejuara në nënzonën II mbrojtëse (zonë natyrore) bazohen në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, në ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 597, datë 25.9.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen ‘Peizazh i mbrojtur ujor/tokësor’” (kategoria V), si dhe në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Pogradec, si më poshtë vijon:

a) Përdorimet e lejuara janë:

i. shtigje dhe ekoturizëm;

ii. të gjitha kategoritë e sistemit natyror dhe ujor;

iii. kategoritë e sistemit bujqësor: B-tokë bujqësore, IB-infrastrukturë bujqësore, EB-ekonomi bujqësore (vetëm nënkategoritë EB1, EB2);

iv. veprimtaritë e parashikuara në pikën 4, të vendimit nr. 597, datë 25.9.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen ‘Peizazh i mbrojtur ujor/tokësor’” (kategoria V).

b) Përdorimet e ndaluara janë:

i. kategoritë e sistemit urban: A-banim, IE-industri e ekonomi, IS-institucione (IS3 shërbim social, IS4-shërbim diplomatik, IS5-institucione financiare, IS6-institucione fetare);

ii. kategoritë e sistemit bujqësor: ekonomi bujqësore (vetëm nënkategoria EB3-agroturizëm);

iii. hapja e guroreve, zhavorrishteve e ranishteve, gjurmimi masiv i dheut dhe hapja e kanaleve;

iv. veprimtaritë e parashikuara në pikën 3, të vendimit nr. 597, datë 25.9.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen ‘Peizazh i mbrojtur ujor/tokësor’” (kategoria V).

3. Në hapësirën e zonës mbrojtëse, e cila përkon me pasurinë natyrore, e shpallur me vendimin nr. 597, datë 25.9.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen ‘Peizazh i mbrojtur ujor/tokësor’” (kategoria V), zbatohet legjislacioni në fuqi për zonat e mbrojtura lidhur me ruajtjen, administrimin dhe mbrojtjen e saj.

4. Në rastet e ndërhyrjeve transformuese dhe me impakt në zonën mbrojtëse të “Ansamblit arkitektonik urban”, nevojitet që projektet të shoqërohen me raportin e ndikimit në trashëgimi (RNT), hartuar në bazë të udhëzuesit të UNESCO-s për vlerësimin e ndikimit në kontekstin e trashëgimisë botërore.

Ndërhyrjet e lejuara në monumentet e kulturës

1. Ndërhyrjet në monumentet e kulturës kanë për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave, për të cilat janë shpallur pasuri kulturore.

2. Ndërhyrjet e lejuara janë:

- a) ndërhyrje sistematike të mirëmbajtjes, konservuese, restauruese;
- b) rijetëzime, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar;
- c) vendosje e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosje e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Neni 9

Ndërhyrjet e ndaluara në tërësinë e “Ansambilit arkitektonik urban” dhe të zonës mbrojtëse të tij

1. Në hapësirën e “Ansambilit arkitektonik urban” nuk lejohen:

- a) instalime që paraqesin rreziqe ose janë të një natyre të rrezikshme, që mund t’u shkaktojnë dëme të rënda ose të pandreqshme njerëzve, pasurive, natyrës dhe peizazhit;
- b) terrene sportive (me sipërfaqe mbi 200 m²);
- c) struktura industriale;
- ç) gurore.

2. Në hapësirën e zonës mbrojtëse të “Ansambilit arkitektonik urban” nuk lejohen:

- a) struktura industriale;
- b) guroret;
- c) përcaktimet në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 7, të këtij plani.

3. Në rast evidentimi të ndërhyrjeve të ndaluara, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, institucionet përgjegjëse në fushën e trashëgimisë kulturore dhe zonave të mbrojtura, marrin masa sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me kompetencën e secilit institucion.

Neni 10

Objektet pa status, pjesë e “Ansambilit arkitektonik urban”

Objektet pa status, pjesë e “Ansambilit arkitektonik urban”, janë objekte të ndërtuara deri në miratimin e këtij plani, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor, nuk janë në harmoni me unitetin kompozicional të tij.

Neni 11

Kriteret e projektimit për ndërhyrjet e lejuara në “Ansamblin arkitektonik urban”, dhe në zonën mbrojtëse

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të “Ansambilit arkitektonik urban” dhe të zonës mbrojtëse të tij, të cilat përcaktojnë objektet ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, rikonstruksione dhe rindërtime duhet të kenë qëllim rritjen e vlerave dhe përshtatjen me karakterin arkitektonik e urbanistik të zonës.

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve ekzistuese në “Ansamblin arkitektonik urban” dhe në nënzonën I mbrojtëse të tij hartohen në varësi të vlerave arkitektoniko-kulturore të objektit, si dhe në bazë të kriterëve për konservim dhe restaurim, sipas kartave ndërkombëtare për restaurim, dhe në bazë të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

3. Projektet për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja, brenda “Ansambllit arkitektonik urban”, hartohen:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të ndërtesave të zonës, elementet origjinale të dukshme, të jashtme e të brendshme, tipologjinë dhe teknikën tradicionale;

b) duke respektuar kushtet zhvillimore e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;

c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë, duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;

ç) duke respektuar kushtin, që lartësia nuk duhet të kalojë lartësinë e dy-tre kateve ose 10.5 m, deri në kornizën e çatisë;

d) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dymëve dhe dritareve, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës;

dh) duket ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çatave në harmoni me peizazhin kulturor të zonës. Çatitë duhet të jenë katër ujëse, me pjerrësi 25–30 gradë dhe të mbulohen me tjegulla vendi ngjyrë të kuqe.

4. Projektet për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja brenda nënzonës I mbrojtëse të “Ansambllit arkitektonik urban” hartohen bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Pogradec, apo në studimet urbanistike e arkitektonike, duke respektuar kriteret, si më poshtë vijon:

a) Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja, apo rikonstruksioneve, përveç rasteve kur për to ka studime të veçanta, nuk duhet t’i kalojë 3-4 katet dhe lartësinë 12.5 m deri në kornizën e çatisë;

b) Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t’i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave, etj.;

c) Çatitë duhet të jenë katër ujëse, të kenë pjerrësi 25-30 gradë dhe të mbulohen me tjegulla vendi ngjyrë të kuqe.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, brenda “Ansambllit arkitektonik urban” dhe zonës mbrojtëse, hartohen:

a) bazuar në parashikimet e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Pogradec;

b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese në mbrojtje;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

6. Projektet e ndërhyrjeve transformuese dhe me impakt në “Ansambllin arkitektonik urban” dhe në zonën mbrojtëse të tij shoqërohen me raportin e ndikimit në trashëgimi (RNT), hartuar në bazë të udhëzuesit në fuqi për pasuritë botërore.

Neni 12

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në “Ansambllin arkitektonik urban” dhe në zonën mbrojtëse

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike, të cilat hartohen për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të “Ansambllit arkitektonik urban”, apo të zonës mbrojtëse të tij, dhe të cilat përcaktojnë objektet ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, rikonstruksione apo rindërtime hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim “IKTK”), Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (në vijim “DRTK”) përgjegjëse për fshatin Lin ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Studimet shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KTKM”).

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin e rijetëzimin në “Ansamblin arkitektonik urban” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Lin ose/dhe nga persona fizikë, apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Lin ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja brenda “Ansambli arkitektonik urban” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Lin ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Lin ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin, rijetëzimin, rikonstruksionet, rindërtimet dhe ndërtimet e reja në nënzonën I mbrojtëse të “Ansambli arkitektonik urban” hartohen nga persona të licencuar për këtë kategori projektesh, bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Pogradec, apo në studimet urbanistike e arkitektonike. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Lin.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore në “Ansamblin arkitektonik urban” dhe zonën mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen e miratohen edhe në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Lin monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

6. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimit e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në “Ansamblin arkitektonik urban” hartohen nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Lin.


7. Për veprimtaritë e lejuara në nënzonën II mbrojtëse zbatohen rregullat e përcaktuara ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, në ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, si dhe aktet nënligjore të tyre.

Projektet shqyrtohen e miratohen edhe në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimit të territorit. DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Lin monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

Neni 13

Dispozita të fundit

Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas konsultimit dhe marrjes së mendimit të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.



KRGJSH 2010

X	Y
553825.3	4546414
553797	4546636
553868.5	4546638
553885.9	4546590
553934.4	4546522
553979.2	4546488
553980.1	4546473
553918.2	4546464
553825.3	4546414
553675.7	4548066
553675.5	4548047
553678.8	4548048
553678.9	4548026
553686.5	4548027
553685.7	4547995
553681.3	4547995
553682.2	4547957
553702.5	4547957
553700.9	4547899
553696.6	4547896
553699.5	4547871
553709.1	4547870
553712.6	4547815
553715.6	4547795
553706.4	4547793
553721.8	4547758
553718.2	4547739
553715.8	4547726
553725.6	4547710
553717.5	4547703
553733	4547680
553708	4547664
553682.1	4547686
553661.4	4547679
553651.3	4547693
553624.2	4547683
553580.1	4547813
553563.2	4547834
553604.8	4548056
553566	4548055
553530.9	4548079
553577.7	4548169
553533.4	4548195
553555.5	4548243
553633.1	4548202
553607.1	4548072

553650.5	4548087
553660.2	4548073
553676.2	4548072
553675.7	4548066
553986.9	4548062
553999.4	4548053
554032.9	4548060
554034.5	4548066
554058.8	4548074
554096.2	4548072
554130.2	4548028
554134.2	4547998
554134.5	4547951
554171.6	4547926
554158.4	4547915
554147.7	4547887
554107.6	4547885
554105.8	4547862
554056.4	4547850
554036	4547824
553987.5	4547851
553974.7	4547895
554020.5	4547901
553998.5	4547910
554010.5	4547938
553987.4	4547948
553996.2	4547969
553968	4547974
553972.2	4547987
553971.6	4548001
553954.9	4548023
553986.9	4548062

KRGJSH 2010

X	Y
553243.3	4545812
553209.2	4545922
553211.3	4546019
553242.9	4546168
553281.7	4546307
553281.9	4546399
553264.6	4546539
553284	4546589
553317.6	4546691
553321	4546722
553346.8	4546753
553354.8	4546820
553361.6	4546870
553361.6	4546890
553363.5	4546914
553370.6	4546942
553366.8	4546963
553359.1	4547009
553335.5	4547054
553334.9	4547068
553308.1	4547435
553265.5	4547906
553256.1	4547976
553249.5	4548035
553239	4548118
553236.1	4548135
553226.4	4548187
553193.3	4548268
553176.6	4548310
553155.6	4548343
553105.1	4548402
552712.4	4548839
552720.4	4548852
552739.9	4548854
552809.2	4548757
552817.3	4548753
552895.6	4548674
552959.4	4548618
553045.5	4548554
553144.3	4548488
553277.6	4548401
553309.3	4548379
553428.4	4548310
553633.2	4548202

553656.6	4548189
553662.1	4548197
553683	4548188
553698.5	4548186
553739.3	4548171
553787.6	4548157
553872.9	4548155
553886.9	4548147
553899.9	4548152
553911.8	4548151
553928.9	4548133
553943.1	4548131
553962.6	4548140
554000.1	4548140
554040.9	4548153
554102.1	4548183
554140.1	4548208
554136.5	4548216
554165	4548279
554168.7	4548298
554178.5	4548328
554250.1	4548424
554263.6	4548424
554286.1	4548462
554303.7	4548479
554338.2	4548474
554377.7	4548456
554414.2	4548468
554431.3	4548449
554435.6	4548440
554428.6	4548415
554428.8	4548367
554430.2	4548354
554419.3	4548326
554390.3	4548296
554377.3	4548271
554353.6	4548239
554303	4548122
554300.6	4548036
554353.1	4547910
554356.3	4547875
554393.4	4547763
554427.7	4547713
554494.2	4547658
554609.2	4547567
554719.4	4547471
554718.1	4547460
554675.9	4547378

554611.8	4547255
554563.7	4547168
554524.3	4547032
554522.9	4547004
554512.9	4547002
554473.4	4546881
554393.5	4546808
554345	4546734
554334.2	4546694
554315.8	4546606
554300.8	4546591
554303.3	4546580
554287.1	4546502
554270	4546443
554191.4	4546377
554144.5	4546381
554038.4	4546467
553999.4	4546470
553979.8	4546486
553981	4546473
553918.7	4546463
553831.8	4546414
553752	4546354
553730.3	4546355
553693.6	4546337
553627.7	4546307
553585.6	4546283
553553.3	4546262
553490.7	4546215
553451.9	4546184
553394.6	4546136
553319	4546060
553253.7	4545937
553243.3	4545812

KRGJSH 2010

X	Y
554390.7	4547649
554343.1	4547704
554283.3	4547768
554277.2	4547788
554276.7	4547883
554234.8	4547940
554217	4547929
554203.9	4547916
554170.8	4547924
554134	4547950

554130.2	4548026
554097	4548074
554061.1	4548074
554037.1	4548069
554032.4	4548061
553999.3	4548052
553988.5	4548063
553974.2	4548050
553955.1	4548050
553934.8	4548056
553892.2	4548061
553839.5	4548093
553811.9	4548096
553760.3	4548087
553712.7	4548054
553678.7	4548072
553660.7	4548073
553653.2	4548089
553606.8	4548070
553632.6	4548202
553655.8	4548189
553661.7	4548198
553685.6	4548188
553696.7	4548187
553785.7	4548157
553872.1	4548156
553886.9	4548147
553909.8	4548152
553928.9	4548133
553942.7	4548132
553965.8	4548141
554003.9	4548142
554048.6	4548157
554116.6	4548189
554138.2	4548206
554136.5	4548217
554165.3	4548280
554173.1	4548318
554196.1	4548356
554249.8	4548424
554265.8	4548426
554275.5	4548439
554284.5	4548459
554304.7	4548479
554337.1	4548476
554362.9	4548460
554375.9	4548456
554413.5	4548469

554431.8	4548448
554435.4	4548439
554427.9	4548405
554430	4548355
554419.1	4548325
554390.6	4548296
554379.9	4548277
554353.9	4548240
554345.4	4548219
554303.3	4548125
554300.2	4548037
554350.9	4547915
554356.1	4547872
554374.4	4547824
554396.3	4547756
554425.6	4547715
554495.6	4547657
554490.1	4547641
554390.7	4547649